



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2017

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Histori e thelluar

Udhëzime të përgjithshme

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

• **Pyetjet me zgjedhje**

Numri i pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	D	C	A	C	A	A	D	C	B

• **Pyetjet me zhvillim**

Pyetja 11 **3 pikë**

- Mbështetja e fortë e dinastisë Tang (610-907) tek budizmi duke e bërë atë mbizotëruese në tërë Kinën gjatë sundimit të vet.
- Një veçori e kulturës mesjetare indiane ishte bashkëjetesa e dy kulturave krejt të ndryshme nga njëra tjetra: hindu dhe muslimane. Si rezultat i kësaj u krijua një kulturë indo- muslimane që shënoi rritje në letërsi, besim, arkitekturë, art, muzikë, veshje.
- Jeta shoqërore e Japonisë ishte e lidhur ngushtë edhe me përhapjen e budizmit. Budizmi në Japoni u pranua në mënyrë zyrtare rreth mesit të viteve 500 dhe në mënyrë të plotë u përhap pas shekullit XIII.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse jep tre argumente.

OSE

2 pikë Nëse jep dy nga argumentet.

1 pikë Nëse jep një nga argumentet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**3 pikë**

Anulimi i reformave të NEP-it dhe shtetëzimi i plotë i të gjitha ndërmarrjeve industriale.

Theksi u vu në zhvillimin e industrisë së rëndë.

Nisi procesi i kolektivizimit socialist të bujqësisë duke zhdukur pronën private në fshat dhe krijimit të njësisive të mëdha të quajtura “kolkoze”.

Zbatimi i drejtimit të ekonomisë nëpërmjet planifikimit me plane 5-vjeçare. Plani ishte i centralizuar, i komanduar dhe i detyruar.

Nxënësi fiton:

3 pikë	Nëse evidenton tre tipare të ekonomisë së BS.
OSE	
2 pikë	Nëse evidenton dy nga tiparet të ekonomisë së BS.
1 pikë	Nëse evidenton një nga tiparet të ekonomisë së BS.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13**3 pikë**

- Nisur nga kjo konsideratë, të huajve u kërkohet që të ishin të perulur e të nënshtuar. Asnjë i huaj nuk mund të jetonte në tokën kineze pa lejen e perandorit.
- Mësimi i gjuhës kineze konsiderohej si akt i jashtëligjshëm dhe i dënueshëm. U vendosën kufizime të rrepta për tregtarët e huaj, ku perëndimorët nuk lejoheshin të futeshin në qytet.
- Kufizimi i marrëdhënieve me jashtë bëri që të ruhen e konservohen strukturat ekzistuese ekonomike e sociale. Rruga për përfitime të ndërsjella e sidomos të përvetësimit të arritjeve në kuadrin e modernizimit u ndërpre. Kështu Kina e izoluar ishte edhe e mbyllur.

Nxënësi fiton:

3 pikë	Nëse shkruan tre argumente;
OSE	
2 pikë	Nëse shkruan dy nga argumentet.
1 pikë	Nëse shkruan një nga argumentet.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14**3 pikë**

- Për shkak të vendimit që u mor nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Paris, që i njohu Italisë pozitën kujdestar ndaj Shqipërisë.
- A. Zogu e shikonte Italinë si një fuqi që kishte potencialin e nevojshëm për ta ndihmuar Shqipërinë në çdo aspekt.
- A. Zogu synonte të shkëputej nga realiteti ballkanik dhe lindor në përgjithësi dhe të orientohej drejt Perëndimit.

Nxënësi fiton:

3 pikë	Nëse jep tre argumente.
OSE	
2 pikë	Nëse jep dy nga argumentet.
1 pikë	Nëse jep një nga argumentet.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 **3 pikë**

- a) Gjermanet kishin shpallur që ishin kalimtarë dhe të përkohshëm në Shqipëri.
- b) Ata kishin shpallur „pavarësinë relative“ për Shqipërinë.
- c) Njohën “Shqipërinë e Madhe“ të krijuar gjatë pushtimit italian.
- d) Ata mendonin se nuk kishin kapacitet ekonomik dhe ushtarak për t’u përballur.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan tre nga të mësipërmet.**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy nga të mësipërmet.**1 pikë** Nëse shkruan një nga të mësipërmet.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 16** **3 pikë**

- a) Privatizimi i sektorit shtetëror dhe kalimi nga “sistemi i ekonomisë mikse” në “sistemin e ekonomisë së tregut”.
- b) Nxitja e nismave të sipërmarrjes së lirë mbi bazën e mekanizmave të tregut.
- c) Ulja e taksave sidomos për korporatat e mëdha dhe për më të pasurit.
- d) Vendosja e kufizimeve për komponentët e Shtetit të Mirëqenies Sociale dhe nxitja e vetë mbështetjes vetjake për sigurimet sociale.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse përshkruan tri nga tiparet e mësipërme.**OSE****2 pikë** Nëse përshkruan dy nga tiparet e mësipërme.**1 pikë** Nëse përshkruan një nga tiparet e mësipërme.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 17** **3 pikë**

- a) Njohja e luftës së popullit shqiptar në kuadër të Luftës së II-të Botërore.
- b) Mundësimi i marrjes së dëmshpërblimeve nga Italia dhe Gjermania.
- c) Hedhja poshtë e pretendimeve territoriale të Greqisë.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan tre nga të mësipërmet.**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy nga të mësipërmet.**1 pikë** Nëse shkruan një nga të mësipërmet.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **3 pikë**

- a) Bilanci i tregtisë u zhvendos tërësisht në favor të Europës.
- b) Prodhimet vendase nuk mund të konkurronin mallrat industrialë të fabrikave perëndimore.
- c) Vendet e lindjes së Mesme u zhytën në një krizë të thellë financiare, për rrjedhojë ata morrën hua nga perëndimi dhe u zhytën në borxhe të mëdha.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse argumenton tre nga pasojat.
- 2 pikë** Nëse argumenton dy nga pasojat.
- OSE**
- 1 pikë** Nëse argumenton një nga pasojat.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 **3pikë**

- a) Ismail Qemali u detyrua të japë dorëheqjen për arsye të ardhjes së Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në 10 tetor 1913 që e trajtoi qeverinë e Ismail Qemalit thjeshtë si një qeveri krahinore dhe u përpoq që të minonte punën e saj.
- b) Rivaliteti që solli Esat pashë Toptani, me largimin nga qeveria e Vlorës dhe krijimi i Pleqësisë së Shqipërisë së Mesme luajtën rol në dobësimin e saj.
- c) Gjithashtu, dështimi në vendosjen e autoritetit të saj mbi gjithë territorin.
- d) Zgjedhja e princ Vidit si monark, i dha goditjen e fundit qeverisë së Vlorës që dha dorëheqjen në fillim të vitit 1914.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse shkruan tre nga argumentet.
- OSE**
- 2 pikë** Nëse shkruan dy nga argumentet.
- 1 pikë** Nëse shkruan një nga argumentet.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **3 pikë**

- a) Kolonistët bënë një luftë të drejtë për pavarësinë e tyre.
- b) Ata kishin epërsinë e njohjes së terrenit dhe përdorën taktikat e luftës jofrontale.
- c) Largësia e madhe nga Anglia që vështirësonte gjendjen për ushtrinë angleze.
- d) Mbështetja që kolonistët patën nga Franca.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse liston tre nga arsyet.
- OSE**
- 2 pikë** Nëse liston dy nga arsyet.
- 1 pikë** Nëse liston një nga arsyet.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.